


Foka e mesdheut

Foka e Mesdheut (*Monachus monachus*)

është një prej llojeve më të rralla të fokës në të gjithë planetin, si dhe gjitari ujqor më i rrezikuar i kontinentit Evropian. Popullata globale e fokës së Mesdheut nuk i kalon 700 individë. Kërcënimet me të cilat haset foka e Mesdheut përfshijnë degradimin e habitatit, shqetësimin gjatë periudhës së riprodhimit, vrasjen e qëllimshme, si dhe ngatërrimin në rrjetat e peshkimit.



Breshka kokëmadhe e detit (*Caretta caretta*)


karakterizohet nga karapaksi me ngjyrë kafe të kuqërremtë dhe kokë shumë të madhe. Arrin një gjatësi rreth 75-110 cm dhe peshon midis 90-160 kg. Jeton deri në 90 vite.

Delfini turishkurtër (*Tursiops truncatus*)

ka një formë të sheshtë të trupit, me kurriz të ngritur dhe buzë të theksuara. Lëkura e tyre është ngjyrë gri në pjesën e sipërme dhe e bardhë në pjesën e poshtme të trupit. Njihet për afritetin me njerëzit, ndjekjen e anijeve dhe inteligjencën e spikatur.

A e dinit se breshka kokëmadhe e detit është një prej llojeve më të vjetra në planetin tonë, që ka mbijetuar periudhën e dinozaurëve?

Breshka kokëmadhe e detit përshkon me mijëra milje midis vendeve të riprodhimit dhe atyre të ushqimit. Gjatë sezonit të riprodhimit, femrat dalin në breg për të vendosur vezët e tyre në plazhet me rërë. Të vegjlit, pasi çelin, orientohen me dritën e hënës drejt detit.



Delfini turishkurtër
pesha 300-500 kg
gjatësia 2.5-4 m

Posidonia (*Posidonia oceanica*) është bimë endemike e Mesdheut që luan një rol të rëndësishëm në ekosistem, pasi formon livadhe nënujore që shërbejnë si strehim dhe ushqim për shumë lloje. Ndiemon në mbrojtjen e bregdetit nga erozioni. Gjatësia e kësaj bime është midis 30 cm dhe 1 m.



Statusi i
Fokës së
Mesdheut
në
Shqipëri



Statusi i
Fokës së
Mesdheut
në nivel
global



Foka e mesdheut © PPNEA



Statusi i
Posidonia
në
Shqipëri

Banorët e thellësisë

Dy detet e Shqipërisë, Adriatik dhe Jon, janë shumë të rëndësishëm për gjallesat që jetojnë në detin e Mesdheut.

Aty gjenden një shumëllojshmëri llojesh detare, duke filluar që nga llojet e rralla si foka e Mesdheut, breshka e detit, bima endemike e Mesdheut Posidonia, e shumë të tjera, të cilat janë thelbësore për ekosistemin dhe zinxhirin ushqimor.

Të gjitha këto lloje përballen me një mori rreziqesh, si ndotja e deteve, kapja aksidentale në rrjetat e peshkimit, ndryshimet klimatike, ndërhyrjet njerëzore në ekosistemet bregdetare, etj.



BIOM (Kroaci), CZIP (Mali i Zi), PPNEA (Shqipëri), dhe MoM (Greqi) janë duke punuar ngushtësisht për identifikimin e habitateve potenciale ku foka e Mesdheut strehohet, si dhe për ndërmarrjen e aksioneve të drejtpërdrejta ruajtëse, duke përfshirë ndërgjegjësimin e turistëve dhe komuniteteve lokale.

Ruajtja e popullatave të llojeve detare është kthyer në prioritet për shumë organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë krijuar edhe një rrjetë ndërkombëtar për përmbytjen e këtij qëllimi, i, si ai për ruajtjen e popullatës së fokës së Mesdheut në brigjet e Adriatikut Lindor.

Në rast se shihni një fokë, breshkë apo delfin përgjatë bregdetit, ju lutemi të kontaktoni menjëherë organizatën PPNEA në numrin +35545628954, ose në adresën e email-it contact@ppnea.org


Skano këtu dhe plotëso formatin e aplikimit.



In partnership with



Supported by



BOTA NËNËNUJORE

Foka e Mesdheut, Breshka e detit dhe Delfini turishkur tër



Albania is Biodiversity